



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 126

28 shtator

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF nr. 20, datë 28.9.2012	Mbi përcaktimin e standardeve të dokumentit për vërtetimin e sasisë së prodhimit për qëllime të përcaktimit të nivelit të detyrimit të akcizës	7105
Vendim i ERE nr.120 datë 29.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Cemerica 1”; “Cemerica 2” dhe “Cemerica 3”	7106
Vendim i ERE nr. 121, datë 29.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	7107
Vendim i ERE nr. 122 datë 29.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Caushi Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Qafëzezë”.....	7108
Vendim i ERE nr. 123 datë 29.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Sa-Gle kompani” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Trebisht”	7109
Vendim i ERE nr. 124, datë 29.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Evn Trading” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	7110
Vendim i ERE nr. 125, datë 29.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	7111
Vendim i ERE nr. 126, datë 29.8.2012	Mbi ankimin administrativ të “Cez shpërndarje” sh.a., në lidhje me vendimin nr. 102, datë 19.7.2012 “Për miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a., dhe “Cez shpërndarje” sh.a.” Bordit të Komisionerëve...	7112
Vendim i ERE nr. 127, datë 30.8.2012	Mbi kërkesën e GSA sh.p.k., dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. mbi zbatimin e vendimit nr.114, datë 22.8.2012.....	7112

UDHËZIM
Nr. 20, datë 28.9.2012

**MBI PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE TË DOKUMENTIT PËR VËRTETIMIN E SASISË
SË PRODHIMIT PËR QËLLIME TË PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË DETYRIMIT TË
AKCIZËS**

Në zbatim të nenit 108 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” dhe me qëllim përcaktimin e standardeve të dokumentit për vërtetimin e sasisë së prodhimit për përcaktimin e nivelit të akcizës së produkteve të pjesës II të shtojcës nr. 1 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në rastin e importit të produkteve që i nënshtrohen akcizës, niveli i taksimit të të cilave sipas shtojcës 1 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” varet nga sasia e prodhimit faktik të vitit të mëparshëm kalendarik, importuesit duhet të paraqesin pranë Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), një dokument me të cilin të deklarohet sasia e prodhimit të kompanisë prodhuese të kësaj kategorie/lloj produkti. Dokumenti duhet të plotësojë njëherazi kushtet e mëposhtme:

a) Të lëshohet nga kompania prodhuese e kategorisë/llojit të produktit të importuar, pavarësisht nga vendi eksportues;

b) Të jetë i certifikuar/miratuar nga autoriteti fiskal mbikëqyrës i prodhuesit në shtetin përkatës;

c) Të tregojë sasinë faktike të prodhimit total të vitit të mëparshëm, jo vetëm për markën dhe llojin e ambalazhit të produktit që po importohet, por totalin e të gjitha markave të produkteve të së njëjtës kategorie/lloj produkti të prodhuar prej kompanisë prodhuese dhe pavarësisht llojit të ambalazhit.

Shembull: kategoria/lloji i produktit të importuar është birra.

Kur fabrika prodhon disa marka të ndryshme birre dhe në lloje të ndryshme ambalazhesh, atëherë dokumenti vërtetues duhet të tregojë sasinë e prodhimit të vitit të kaluar, jo vetëm për markën dhe llojin e ambalazhit të birrës që po importohet, por për totalin e të gjitha markave të birrës të prodhuara për çfarëdolloj ambalazhi të përdorura në të njëjtën fabrikë.

2. Në rastet e prodhimit në territorin shqiptar të produkteve, që i nënshtrohen detyrimit të akcizës dhe kur niveli i taksimit të të cilave sipas shtojcës 1 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, varet nga sasia e prodhimit faktik të vitit të mëparshëm kalendarik, prodhuesit vendas duhet të paraqesin pranë Departamentit të Akcizës në DPD një vërtetim nga autoritetet tatimore, ku të përcaktohet sasia e prodhimit faktik të fabrikës.

3. Pas certifikimit të sasisë së prodhimit, si në import ashtu edhe në prodhimin vendas, Departamenti i Akcizës në DPD do të përcaktojë nivelin e taksimit me akcizë për çdo produkt që i nënshtrohet këtij kriteri përgjatë një viti kalendarik dhe njëkohësisht informon autoritetet doganore mbikëqyrëse.

4. Niveli përkatës i taksimit të akcizës gjatë deklarimit në procedurat e importit apo të deklarimit nga prodhuesit vendas, do të jepet pas paraqitjes dhe pranimit të dokumentit të vërtetimit si të vlefshëm.

5. Në rast të mosparaqitjes së këtij vërtetimi ose të paraqitjes së një vërtetimi, që nuk i plotëson kriteret si i tillë, nga organet doganore do të aplikohet shkalla më e lartë e nivelit të akcizës për çdo kategori produktesh, duke informuar importuesin apo prodhuesin për arsyet e refuzimit.



6. Autoritetet doganore, në kuadër të marrëdhënieve të ndërsjella dhe marrëveshjeve të ndryshme në fuqi me autoritetet doganore homologe apo strukturat e tjera kompetente, mund të bëjnë verifikimin e këtyre vërtetimeve.

7. Në rast se nga verifikimet e kryera, sipas pikës 6 më sipër, apo çdo lloj verifikimi tjetër dokumentar apo/dhe fizik të ngarkesës, rezulton që nuk plotësohen kushtet apo kriteret e këtij udhëzimi, atëherë:

- a) niveli i diferencuar i taksimit për shkak të sasisë së prodhimit, pushon së qeni i vlefshëm;
- b) zbatohet niveli maksimal i taksimit;
- c) aplikohet kontroll aposterior mbi deklaratimet e mëparshme, të cilat kanë përfituar nga vërtetimet jashtë kriterëve, si dhe aplikohen sanksionet përkatëse për shmangie të detyrimit të akcizës.

8. Vërtetimet e sasisë së prodhimit për përcaktimin e nivelit të akcizës së produkteve të akcizës, të depozituara pranë degëve doganore, në rastet e importit, mund të përdoren deri në datën 15 tetor 2012.

Për të gjitha rastet e importit deri më 15 tetor 2012, për të cilat ka pasur vërtetime prodhuesi të depozituara pranë degëve doganore, niveli i detyrimeve të akcizës do të vazhdojë të aplikohet sipas vërtetimit ekzistues, duke depozituar garanci për diferencën e detyrimit të akcizës si pasojë e nivelit të diferencuar. Garancia depozitohet pranë zyrës së financës të degës doganore përkatëse.

Importuesit duhet të rinovojnë vërtetimet e prodhuesit sipas kriterëve të këtij udhëzimi.

Nëse pas datës 15 tetor 2012:

- a) nuk janë depozituar vërtetimet e rinovuara;
- b) vërtetimet që depozitohen nuk plotësojnë kriteret e këtij udhëzimi;
- c) vërtetimi i rinovuar tregon për një sasi prodhimi të ndryshme nga vërtetimi i mëparshëm, garancia nuk rikthehet dhe preket nga autoritetet doganore për efekt të pagesës së diferencës së detyrimeve të akcizës.

Nëse pas datës 15 tetor 2012 vërtetimet e rinovuara plotësojnë kriteret e këtij udhëzimi, garancia rikthehet.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 tetor 2012 dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr. 120, datë 29.8.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “REJ ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET “CEMERICA 1”;
“CEMERICA 2” DHE “CEMERICA 3”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, nenit 5 pika 1 germa “a” dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Rej Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rej Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Cemerica 1” me fuqi të instaluar 0.88 MW; “Cemerica 2” me fuqi të instaluar 0.9 MW dhe “Cemerica 3” me fuqi të instaluar 2.1 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 121, datë 29.8.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “REJ ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”; nenit 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pikat 1 germa “a” të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, pikat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rej Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë, për një afat 30-vjeçar.
 2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM Nr. 122, datë 29.8.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “CAUSHI ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “QAFËZEZË”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, nenit 5 pika 1 germa “a” dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Caushi Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Caushi Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Caushi Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Qafëzezë” me fuqi të instaluar 0.4 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 123, datë 29.8.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SA-GLE KOMPANI” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TREBISHT”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SA-GLE Kompani” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrotjtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “SA-GLE Kompani” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “SA-GLE Kompani” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Trebisht”, me fuqi të instaluar 1.775 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 124, datë 29.8.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EVN TRADING” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EVN Trading” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 125, datë 29.8.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 126, datë 29.8.2012

**MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË LIDHJE ME
VENDIMIN NR. 102, DATË 19.7.2012 “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS OST SHA DHE “CEZ
SHPËRNDARJE” SHA” BORDIT TË KOMISIONERËVE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi ankimin administrativ të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin nr. 102, datë 19.7.2012,

VENDOSI:

1. Të mos pranojë ankimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marrë në datën 19.7.2012, dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 102, datë 19.7.2012 “Për miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe CEZ Shpërndarje sh.a.”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 127, datë 30.8.2012

**MBI KËRKESËN E GSA SHPK DHE “RUDNAP ENERGY TIRANA” SHPK MBI
ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 114, DATË 22.8.2012**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë GSA sh.p.k. me nr. 29.8.2012 prot., datë 29.8.2012 dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. mbi zbatimin e vendimit të ERE-s nr. 114, datë 22.8.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

duke konsideruar se:

Vendimi nr. 114, datë 22.8.2012, përcaktonte alokimin e kapaciteteve disponibël të interkonjeksionit për muajin shtator 2012 shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për sasinë 155 MW,

për mbulimin e humbjeve të ndara sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST sh.a., si dhe klientëve të kualifikuar për sasinë 45 MW, të ndara proporcionalisht sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST sh.a. me kusht “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe furnizuesit e kualifikuar të bëjnë nominimet dhe pagesat për kapacitetet e interkonjeksionit.

Në datën 29.8.2012, në kushtet e moszbatimit nga “CEZ Shpërndarje” të detyrimit sipas pikës 3 të vendimit nr. 114, datë 22.8.2012, OST zhvilloi ankandin për alokimin e kapaciteteve të akorduara sipas pikës 1 të këtij vendimi shoqërisë “CEZ Shpërndarje”.

Çmimet për kapacitet sipas kufijve përkatës, në përfundim të ankandit rezultuan të ndryshëm nga çmimet e përcaktuara në ankandin vjetor të zhvilluar nga OST, duke vendosur subjektet e përcaktuara në vendimin nr. 114, datë 22.8.2012 (furnizuesit e kualifikuar) në kushtet e pabarazisë me pjesëtarët e tjerë të tregut që ju alokuan kapacitet sipas ankandit të zhvilluar nga OST për muajin shtator 2012.

Vendimi nr. 114, datë 22.8.2012 reflektonte parimin e barazisë në alokimin e kapaciteteve dhe pagesës përkatëse ndërmjet pjesëtareve të tregut.

Rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuara nga ERE me vendimin nr. 13, datë 22.2.2011, përcaktojnë se llogaritja e çmimit përfundimtar për kapacitet bazohet në renditjen e ofertave, duke filluar nga çmimi më i lartë për të përfunduar me çmimin më të ulët.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Subjektet e përcaktuara sipas detyrimeve në pikën 3 të vendimit nr. 114, datë 22.8.2012, do t'i paguajnë OST për kapacitetet e interkonjeksionit, sipas rezultateve dhe drejtimeve të përcaktuara në ankandin e zhvilluar në datën 29.8.2012, nga OST, për muajin shtator 2012.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve, shoqëritë OST sh.a., GSA sh.p.k., dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. që preken nga ky vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 28.9.2012
Doli nga shtypi më 28.9.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 18 lekë